

Këshillat e Specialistit për Blerjen e Kafshëve

Kur blini kafshët duhet të merni disa konsiderata të përgjithshme siç janë :



- Kondicioni i referohet peshës trupore ose majmërisë së gjedhit. Gjedhi duhet të jetë i shëndetshëm dhe pa dhjamë. Në përgjithësi përjashtohen kafshët që nuk kanë arritur performanca teknike. Ato mund të jenë me çmim më të lirë pasi nuk kanë arritur nivelin e pranueshëm të performancave.
- Shëndeti është kondicioni i përgjithshëm fizik i kafshës. Kafshët që ju do të blini duhet të kenë qime të lëkurës të ndritshme dhe jo të zbehtë me pamje. Duhet të vëzhgohet një frymëmarrje normale. Përjashtoni kafshët me rrjedhje të hundëve dhe me mungesën e syve të ndritshëm. Përpikuni të vëzhgoni në vesh për ndonjë shenje vaksinimi për tu ndihmuar rreth kujdesit që kafshët kanë marre gjate periudhës së rritjes.
- Lëvizshmëria është një tjetër konsiderate e shëndetit të kafshëve që duhet të merret parasysh. Thjesht vështro kafshët që levizin rreth e rrotull. Një kafshë duhet të ketë aftësinë për të lëvizur lirisht pa probleme në këmbët, artikulationet. Përjashto kafshët me probleme në këmbët si ënjtje, ose dëmtime të tjera fizike.
- Madhësia Trupore është veçanërisht e rëndësishme nëqoftëse ju mbarështoni kafshë për treg. Gjedhi me masë trupore të vogël do të përfundojë me peshë të lehtë ndërsa gjedhi me madhësi trupore të madhe përgjithësisht do të ketë peshë të madhe trupore sepse ato mund të mbajnë më shumë mish mbi një skelet të madh.
- Ndërzimi. Blerja e mëshqerrave barrse do t'ju japë ju një fillim të shpejte për programin tuaj së sa blerja e mëshqerrave ose lopëve jo-barrse. Megjithatë, bëni kujdes kur blini lope jo-barrse ose të pa ndërzyer pasi kjo mund t'ju kushtojë me shumë. Lopa jo-barrse mund të jetë një indikator që lidhet me probleme në shëndetin riprodhues të kafshës. Lopët që nuk mbarsen janë investime që rezultojnë me humbje potenciale. Nëqoftëse ju blini një ose disa lope në të njejten kohë është mirë që ato të jenë barrse të konfirmuara nga specialisti veteriner para blerjes së tyre. Rezultatet e konfirmimit të barrsmërisë duhet të bëjnë pjesë në marrëveshjen e blerjes.

Departamenti i Blegtorisë, QTTT-Fushë Krujë:

E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

Përmirësimi i tokave acide dhe magneziale nëpërmjet përdorimit të gëlqeres



Gëlqerimi: Një nga rrugët kryesore të përmirësimit të tokave acide dhe magneziale është gëlqerimi i tyre (përmirësimi kimik), nëpërmjet të cilit neutralizohet aciditeti i tokës dhe përmirësohet raporti kalcium/magnez (Ca:Mg) në favor të kalciumit, rritet sasia e formave të asimilueshme për bimët, përmirësohen cilësitë fizike, ujore, strukturale, kimike dhe mikrobiologjike të tokës, krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mikroorganizmave në tokë dhe pasuron tokën me kalcium. Gëlqerimi ndikon gjithashtu edhe në përvetësimin e potasit (K₂O) e fosforit (P₂O₅) nga bimët si dhe elementë të tjerë ku mund të theksojmë sidomos mikroelementet. Gjithashtu ai shërben si ushqim kalçik i domosdoshëm për rritjen, zhvillimin e prodhimin e bimëve bujqësore. Me rëndësi për shtimin e prodhimit është përdorimi i përbashkët i gëlqeres me plehun organik sesa nga përdorimi i veçuar i tyre. Gëlqerimi i mbulon shpenzimet që në vitin e parë të përdorimit duke dhënë një shtesë prodhimi 5kv/ha e më shumë grurë dhe efekti i gëlqerimit është jo më pak së 5 vjet nga koha e përdorimit të tij.

Departamenti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Tokës e Ujit, QTTT-Fushë Krujë:

E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

Kujtesë për fermerët që kultivojnë perime.



Perimet kanë një rendësi të madhe në ekonominë tonë por sidomos nga vlerat ushqimore që ato kanë.

Nga ana tjetër duhet njohur së puna në perime ka sjelle një progres të dukshëm në drejtim të rritjes së prodhimit, hershmërisë, qëndrueshmërisë ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve si dhe në drejtim të përmasimit të treguesve që lidhen me cilësinë e prodhimit.

Ndërkaq del e domosdoshme një vëmendje të veçantë të specialisteve në këtë fushë, ku fermerët duhet të marrin shumë informacion për perimet në drejtim të mbjelljeve, prodhimit si dhe çmimit që shitet çdo ditë në treg.

Në serra:

Me rritja e ndjeshme të temperaturave do një kujdes të veçante në regjimin termik të serrave ku përfshihet ajrosja e tyre. Në këtë kohë regjimi termik i tyre ndikon ndjeshëm në ecurinë e prodhimit si sasi dhe cilësi. Një kujdes të veçantë duhet patur me trajtimet kimike, për arsye së sëmundjet janë të pranishme dhe janë në fazën e tyre.

Në domate.

Kultivuesit e domates duhet të kenë parasysh së këto ditë duke planifikuar prodhimin që ato do të marrin, ose në vartësi të kateve sipas cipeve të serrave duhet të këpusin majën rritëse të bimës. Perimet plotësues nuk duhet të ndërpriten duke përdorur plehra komplekse 20-20-20. Në këtë fazë bima kërkon një kujdes së një plehërim i gabuar si shembull duke hedhur më shumë potas bima nuk rrit frutat. Përsa i përket trajtimeve kimike kujdes duhet nga vrugjet, kalbëzimi i frutave dhe dëmtuesit si tenja minuese, merimanga etj.

Në kastravec.

Kastraveci është në fazën e kulmit të prodhimit të tij prandaj duhet që të mos ndërpritet ushqimi që rendimenti të jetë sa më i lartë, ndryshe nga domatja kastraveci kërkon formula të tjera plehërimi ku duhen doza të larta azoti dhe potasi që bima të japë maksimalen e rendimentit. Përdorimi i lartë i sasisë së potasit të bima e kastravecit rrit ndjeshëm cilësinë e frutit dhe pamjen e tij, gjë që pëlqehet nga konsumatori. Në këtë kohe kastraveci kërkon ujë dhe ushqim me bollëk. Përsa i përket trajtimeve kimike në kastravec tani janë të pranishme vrugu, hiri dhe morri. Trajtimet duhet të kryhen rregullisht çdo 7-10 ditë.

Në pjepër.

Në serrat të mbjella në pjepër tani në këtë fazë vazhdon rritja e frutave, plehërimet duhet të jenë me fosfor dhe potas për të rritur frutin dhe rendimentin. Përsa i përket trajtimeve kimike në pjepër tani janë të pranishme vrugu, hiri dhe morri. Trajtimet duhet të kryhen rregullisht çdo 7-10 ditë.

Në spec.

Speci tani në këtë fazë kërkon të këtë ushqimin dhe ujitjen e pandërprerë. Kërkohet kujdes në krasitjet sipas hibrideve që e kanë të domosdoshëm sepse ulet prodhimi dhe cilësia. Përsa i përket trajtimeve kimike speci kujdes të veçantë do në kalbëzimin e qafës, prandaj duhet që çdo 10 ditë të trajtohet me preparate të kalbëzimit.

Perimet në fushë:

Fermerët kanë mbjellë në fushë dhe duhet kujdes në ujitjet dhe plehërimet plotësuese dhe shërbimet sipas kulturave në veçanti. Të gjithë kultivuesit me tunele të kenë parasysh së duhet të hiqen tunelet së mund të dështojnë frutat në lidhjet e tyre. Temperatura e lartë brenda tunelit krijon dështimet e frutave, ndodh dhe një fenomen tjetër lulet nuk pjalmohen kur janë në këtë faze në tunele. Përsa i përket trajtimeve kimike në perimet e fushës tani janë të pranishme vrugu, kalbëzimi i qafës dhe dëmtuesit e ndryshëm. Trajtimet duhet të kryhen rregullisht çdo 7-10 ditë.

Departamenti i Perimeve: QTTB-Lushnje

E-mail: qttblushnje@yahoo.com

QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

Këshillat e ekspertit në fushën e pemtarisë.



Momentet kryesore agroteknike në pemëtari për periudhën deri në 30.05.2010
Të vazhdojë procesi i frezimeve dhe kultivimeve të tokës në pemëtore, vreshta, ullishte e agrumishte, për luftimin e barnave të këqia dhe ruajtjen e lagështisë në tokë.


- Të kryhen shërbimet agroteknike në fidanishtet dhe shartesoret e hardhisë (ujitja, prashitja e trajtimet kimike).
- Është momenti i përshtatshëm për luftimin e morrave në pemët frutore duke përdorur kryesisht insekticide sistemikë. Të shoqërohet kjo me zhdukjen e barnave të këqia rreth parcelave, si strehuese kryesore të insekteve të dëmshme.
- Të kryhet trajtimi i vreshtave për luftimin, e vrugut me preparate sistemike si Ridomil, Galben, etj. dhe të hirit e këpushave me Kumulus, Punch, Falcon etj.
- Të vazhdojë tëharrja e vreshtave dhe sqetullimi për vendosjen e ekuilibreve të drejta masë vegetative-prodhim. Po ashtu të kryhet pastrimi i trungjeve nga lastarët e dalë nga sythat fjetës si konkurrues të bimës.
- Të vazhdojë rrallimi i frutave edhe në zonën e lartë, në kultivarët e pjeshkës, kajsisë e dardhës, kur të kenë arritur madhësinë e kokrrës së lajthisë.
- Të intensifikohet puna për luftimin e barnave të këqia nëpërmjet trajtimeve me herbicide, rrotull parcelave, apo në midis rrjeshtat e blloqeve, (duke përjashtuar parcelat me mbjelljet e reja, si dhe kontaktin me bimët). Si herbicide të efektshëm mund të përdoren Raundup, Gramixel, Maestro etj në dozat 400 litra solucion për ha me koncentracion për çdo rast konkret sipas etiketës shoqëruese të përdorimit, mbështetur në lëndën aktive.
- Në agrume, mbi bazë të vrojtimit për infeksionin nga “tenja minuese” dhe morrave të kryhen trajtime me Confidor apo preparate të tjera sistemike.
- Të vazhdojë krasitja formuese dhe prodhuese në kulturën e agrumeve. Në vartësi të kushteve klimatike mund të fillohet edhe me ndonjë ujitje në këtë kulturë.

Departamenti i Pemëtarisë QTTB-Vlorë:

E-mail:qttbvlore@yahoo.com

QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Këshilla për Fermerët që Mbarështojnë Bagëti të Imta



Të njohim racat e pastra (bërthamat racore) të bagëtive të imta që mbarështohen në Departamentin e Blegtorisë, QTTB-Korçë.

-Departamenti i Blegtorisë Q.T.T.B. Korçë është e vetmja qendër në shkallë vendi që mbarështon raca të pastra dhen, dhi, gjedhë të zonave malore dhe ndihmon në përmirësimin racor të kafshëve, rritjen e prodhimeve blegtorale dhe të ardhurave prej tyre.

Në vartësi nga dëshira e fermerit për të bërë përmirësim racor, pra për të rritur prodhimet blegtorale, përcaktohet edhe raca me të cilën do të punohet.

Për prodhimin e qumështit nga dhitë

Departamenti i Blegtorisë mbarështon dy raca të dalluara për prodhim qumështi nga dhitë ; Racën Alpine dhe Sanna.

Treguesit	Raca Alpine		Raca Sanna	
	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull
Pesha në lindje	3.5 -4.5	3-3.5	3.8-4.6	3.3-3.9
Pesha e gjallë – kafshë e rritur		80-100	50-65	80-120
Pesha në këputje	15	14	16	15

Mosha optimale e ndërzimit të parë	7 Muaj	7 Muaj
Pesha optimale e ndërzimit të parë	31-32 kg	33-35 kg
Prodhimi i qumështit në laktacioni	kg 700- 900 kg	750-950
% e yndyrës në qumësht	3.6	3.3
% e proteinës në qumësht	3.36	3.05
% pjellorisë	130-175	130-175
% pjellshmërisë	95-100	95-100

Këto dy Raca janë adaptuar plotësisht dhe mund të shkojnë në të gjitha zonat e vendit tone. Janë shfrytëzueshme shumë të mira të ushqimeve në kullotë dhe në grazhd.

Fermerë Ju rekomandojmë që:

Puna racore me këto raca të zbatohet si me poshtë:

1. Në zonat fushore me prodhime bujqësore intensive me tufa të vogla (15-20 krerë), mund të zhvillohet race e pastër dhe kryqëzime deri në gëlltitje të plotë të këtyre dy racave.
2. Në zonat malore dhe kodrinore ku kushtet janë më të vështira, të përdoret vetëm një futje gjaku (deri në F1)

Nga studimet e kryera nga Departamenti i Blegtorisë Korçë, rezulton së kryqëzimet e dhive të vendit me racat Alpine & Sanna kanë dhënë këto rezultate:

- Në dhitë e breznisë së I-re (F1) prodhimi i qumështit ka një rritje të ndjeshme prej rreth 35-40 % në krahasim me racat e vendit, rritje të pjellorisë, peshës trupore, gjithashtu dhitë e kësaj breznie ruajnë fortësinë konstitucionale të trashëguar nga nëna dhe ndjekin shumë mirë kullotat ashtu si dhitë e vendit.
- Përbërja e qumështit (Yndyrë, Proteinë), dinamika e zhvillimit, dhe qëndrueshmëria ndaj kushteve të ambientit, sëmundshmërisë e tjerë, është afërsisht me ato të dhive të popullatave të vendit tonë.
- Nuk duhet avancuar me rritjen e gjakut në këto zona sepse me avancimin e breznive të kryqëzimeve është vënë re një dobësim i konstitucionit të dhive, ulje të aftësisë së përshtatshmërisë në kushtet e zonës malore, mos shfrytëzim i mirë i kullotave, prekshmëri ndaj sëmundjeve etj..

Pra rekomandojmë që në këto zona kryqëzimi të bëhet me një futje gjaku deri në brezninë e parë (F1)

Departamentit i Blegtorisë QTTB-Korçë:

E-mail: qttbkorce@yahoo.com

QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODER

Këshilla për fermerët që kultivojnë misrin, periudha 10 deri me 25 Maj



- Përshpejtim i përmbjlljes së mbjelljes së misrit për kokërr dhe silazh në zonat malore si dhe parcelat e zëna me kultura të dyta, hasëlle, jonxhishte të vjetra etj në zonën fushore.
- Të zgjedhim e të mbjellim hibridin e përshtatshëm sipas destinacioni për kokërr apo për silazh.
- T'i kushtojmë kujdes plehërimit baze para mbjelljes. Çdo gabim tani nuk mund të ndreqet me vonë.
- Parcelat e infektuara nga barërat e këqija të trajtohen me herbicideve efikase. Rekomandojmë ato që përdoren pas mbjelljes por para mbirjes së misrit. Në rastin e parcelave të mbira e të infektuara të përdoren herbicide specifike, të rekomanduara nga specialistet e shërbimit këshillimor.
- Në ngastrat e mbira të ndërhyjmë me kultivime shkrifëruese në fazën e 3-4 gjetheve. Në këtë fazë bëhet edhe rrallimi si dhe plehërimet e para plotësuese me plehra azotike.
- Të bëhet kujdes për infeksionin nga krimbi i murrme i tokës. Në raste të tilla të përdoren insekticide specifike si dhe shërbime të shpejta për shkrifërimin e tokës dhe ajrosjen e saj.

Departamentit të Bujqësisë, QTTB-Shkodër:

E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

Këshilla e specialistit për mbrojtjen e kulturave për muajin Maj 2010



1-Kultura e grurit.

Ne këtë kulturë priten këto probleme:

- a) Sëmundjet. Do të kemi zhvillim të epifitise së ndryshkut dhe fuzariozes në kalli si rezultat i reshjeve të rena gjate muajit Prill. për këto bime nuk mendohet të ndërhyhet pasi trajtimi ndaj sëmundjeve është i paleverdishëm ekonomikisht.
- b) Dëmtuesit gjate dhjete-ditorit të parë, kemi përfundimin e zhvillimit larvar të lemës dhe zhvillimin e kolonive të afideve në kalli. Edhe për këta insekte nuk justifikohet ekonomikisht trajtimi, pasi dendësia e lemës nuk pritet t'i kaloje kufijtë kritik dhe afidet shoqërohen me predatime nga *Coccinella* sp.

2-Kulturat e perimeve në serra.

Nisur nga ecuria klimatike e muajit Prill, rezerva e patogjeneve dhe insekteve parazitë pritet një situatë e tillë:

- a) Sëmundjet: Problemi kryesor do të jetë vrugu i domates i cili mund të arrijë të parazitohet edhe frutat e saj. Njolloshja kafë e domates e cila dëmton shumë rendë masën vegetative të bimëve; *Alternaria*, *Botritis*, *Vyshkja* bakteriale do të jenë probleme prezentë në trangull, bostan, kungull, pas 10 ditore të pare priten epifiti nga vrugu si dhe prekje nga *Botritis* në spec priten infeksione nga vrugu i kërcellit *Phytophthora capsici* si dhe *botritis*. Ndaj tyre mund të ndërhyhet me *Ridomil*, *Dakonil*, *Frumidor*, *Antracol*, *Champion*, *Bavistin*, *Benlate*, *Enovit*, *Polyram*, *Curzate*, *Aviso* etj.
- b) Dëmtuesit : *Krahëbardha*, *Afidet*, *Liriomiza*, *merimanga*, *tripsi* në trangull priten të jene organizmat e dëmshme shoqëruese të perimeve në serra. Ndaj ketyre mund të ndërhyhet me *Salut*, *Confidor*, *Aktelik*, *Tri-gard*, *Mitak* etj. në serat me rezerve të lartë të nematodesh pritet dhënia e tipareve të demit nga ky parazit.

2.1-Perimet e fushës

Ne patllixhani priten dëmtime nga pleshti i duhanit, breznia e parë e të cilit del nga 18-25 Maj, gjithashtu priten dëmtime nga buburreci i patates si dhe fillimi i infeksioneve të morrit të pjeshkës në dhjetëditori i trete i muajit. Një tjetër parazit i mundëshe në këto momente do të jetë edhe *merimanga* e zakonshme.

Shënim: të kihet kujdes në përdorimin e *Piretroideve* dhe *Carbamateve*, pasi janë faktor e shtimit masiv të tyre.

Ne domate, patate, speca priten infeksione nga vrugjet si dhe dëmtime nga buburreci, afidet, *merimanga* dhe krimbat.

Në qepë do të vazhdojë rritja e infeksioneve të vrugut (*P.shleideni*).

3-Pemët frutore-farore.

Në mollë, dardhë, ftua dhe arrë, priten në dhjetëditorin e dytë infeksionet nga krimbat specie të gjinisë *Cydia* në molle, dardhe, do të kemi infeksione nga kroma dhe kalbëzimet.

Molla do të jetë në lulëzim edhe gjatë 10 ditore të parë të muajit maj. Kjo vonesë e lulëzimit kërkon që të vazhdojnë trajtimet kimike kundër lule ngrënësit dhe hundëgjatit të cilët kanë një përhapje të gjerë. Po ashtu trajtime duhet të kryhen dhe kundër kromës së mollës dhe hirit, të cilat janë shfaqur dhe që favorizohen nga kushtet me lagështi të motit.

4-Pemët frutore bërthamore.

Në pjeshkë do të kemi prekje të majave të lastarëve dhe frutave nga tenjat e lindjes *G. molesta*, si dhe *A. lineatella*, po ashtu afidet do të vazhdojnë të jenë të pranishme me disa specie si: *M. persicae* dhe morri i trungut në kumbull e kajsi, priten dëmtime nga breznia e parë e *cidiave* si dhe vazhdimësi e infeksioneve nga afidet.

5-Kultura e hardhisë

Në fund të dhjetëditorit të parë pritet gjenerata e parë e vrugut të hardhisë, njollat e vajit u shfaqen me datën 25 prill, dalja e larvave të tenjës, vazhdimi i parazitizmit nga këpushat eriofide. Në vazhdim të muajit do të kemi infeksione nga hiri në varësi të ecurisë së motit. Për këto lipset të kryhen trajtime me intervale 10-14

ditor me preparate sistemime të alternuara me ato të kontaktit për sëmundjet dhe me preparatet sa me pak të dëmshëm për entomofaunen e dobishme për të mos agravuar me tej problemin e këpushave eriofide.

6-Kultura e jonxhës.

Nëpër jonxhishte do të jenë të pranishëm hundëgjatët si dhe çimka e jonxhës.

7-Ulliri

Në dhjetëditorin e tretë priten dëme nga tenja si dhe pambukorja e ullirit, po ashtu dhe vazhdimi i infeksioneve të gjetheve të reja nga syri i palloit.

8-Agrumet

Ne agrume priten parazitime nga afidet, krahëbardha, si dhe fillimet e breznisë së pare të tenjës gjarpëruese të gjetheve të agrumeve

9-Kultura e duhanit.

Në dhjetëditorin e dytë fillon dalja e individëve të breznisë së parë të pleshtit. Prandaj nevojitet të ndërhyhet kur dendësia e tyre e kalon kufirin kritik mbi 3 individë për bimë. Njëkohësisht në këto momente do të fillojnë të shtohen edhe popullatat e morrave, të cilët duhet të mbahen nën kontroll dhe të ndërhyhet kur ato e kalojnë kufirin ekonomik të demit.

10-Kultura e misrit

Ne dhjetëditorin e fundit të muajit pritet çelja e larvave të krimbave. në misrin që është në mbirje e sipër, problem do të jenë dëmtuesit e tokës. Në fund të muajit prill është konstatuar përhapja e krimbit të murrme në disa parcela. të mbahet nën kontroll ky dëmtues dhe kur arrin të dëmtoj 5 % të bimëve të kryhen trajtimet kimike (nisur nga veçoria e dëmtuesit, trajtimet kimike do të kryhen natën).

11- Shalqi me tunel

Të rritet kujdesi për luftimin e kalbëzimit të rrënjëve, duke përdorur gjatë vaditjes me pika 0.5-1 kg Bavistin ose Benomil.

12- Panxhar

Dëmtuesi kryesor dhe më i rrezikshëm për fazën e mbirjes të kësaj bime është pleshti i panxharit. Trajtimi kimik i të cilit nuk duhet të nënvlerësohet. Vrojtimet të kryhen edhe për hundëgjatën i cili në parcela të veçanta mund të jetë me infeksione të renda.

Më shumë informacion kontaktoni në Laboratorin e Mbrojtjes Bimëve në Durrës.

Mobil: 0682251957; emali: shpend.shahini@gmail.com